

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6655
E shtunë, 16 korrik 2022
çmimi 0.40 €

Ujë i pakontrolluar rrjedh në krojet e qytetarëve të Kosovës



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PDK-ja: QEVERIA KURTI PO THELLON VARFËRINË, MIGRIMIN DHE FALIMENTIMIN E FIRMAVE



Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kërkuar nga qeveria Kurti që të reagojë urgjentisht në lidhje me krizën ekonomike në vend. Zyrarë të kësaj partie kanë vlerësuar se rritja e çmimeve të të gjitha produkteve esenciale, inflacioni dhe mosveprimi i qeverisë me pako konkrete, është duke ndikuar që

familjet të shkojnë drejt varfërimit, punëtorët drejt Perëndimit dhe firmat drejt falimentimit. Në këtë kontekst, Blerand Stavileci dhe Arben Mustafa, kanë kërkuar nga qeveria Kurti t'i lirojë nga TVSh-ja mallrat esenciale të konsumit dhe ta heqë akcizën në produktet e naftës për një periudhë të caktuar kohore

OPINION

OPOZITËS I THËNÇIN OPOZITË, OPOZITARIZMI KREJTËSISHT I TREDHUR! F.6

Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA



AKTUALE



OSMANI PRET MBËSHTETJEN E POLONISË NË RRUGËTIMIN EUROATLANTIK TË KOSOVËS F.7

RINOVHET MONUMENTI I NATO-S NË PRIZREN F.3

DORËZOHET NË KUVEND PETICIONI ME 21 MIJË NËNSHKRIME PËR TËRHEQJEN E MJETEVE NGA TRUSTI F.7

EKONOMI



RAFUNA: DO TA AVANCOJ BASHKËPUNIMIN E BIZNESEVE BRENDA DHE JASHTË KOSOVËS F.8

CILËSIA E GRURIT NË KOSOVË, NËN NORMALEN F.8



KELMENDI VIZITON DREJTUESIT E UÇK-së NË HAGË: GJYKATA SPECIALE ËSHTË E NJËANSHME

FAQE 5



1 219 RASTE TË REJA ME COVID BRENDA 24 ORËVE NË KOSOVË

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shpallet antikushtetues ligji që mohonte gjenocidin në Bosnjë

SARAJEVË, 15 KORRIK - Gjykata Kushtetuese e Bosnjë dhe Hercegovinës (BeH) e ka shpallur antikushtetues Ligjin për moszbatimin e vendimit të përfaqësueses së lartë në Republika Srpska (RS) i cili i referohet mohimit të gjenocidit në Srebrenicë dhe glorifikimit të kriminelëve të luftës. Kështu ka bërë me dije Gjykata Kushtetuese të premten, më 15 korrik. Vendimi është marrë në bazë të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së atij ligji, e cila është dërguar nga shtatë delegatë në Këshillin e Popujve të Republika Srpskas. "Gjykata Kushtetuese është udhëhequr nga praktika e saj e mëparshme në disa raste të ngjashme, sepse përfaqësuesi i lartë ka vepruar si institucion legjislativ, duke zëvendësuar autoritetin kompetent, që në këtë rast është Asambleja Parlamentare e



Bosnjë-Hercegovinës", ka thënë Mirsad Çeman, zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës në konferencën për gazetarët në rrethin Brčko. Delegatët e kanë paraqitur ankesën në Gjykatën Kushtetuese të Bosnjë-Hercegovinës pasi Gjykata Kushtetuese e Republikës Srpska ka hedhur poshtë veton e Klubit Boshnjak në Këshillin e Popujve të RS-së për ligjin e miratuar në shtator të vitit të kaluar. Këshilli për Mbrojtjen e Interesit Vital Kombëtar pranë Gjykatës Kushtetuese të RS ka vlerësuar në atë kohë se ligji nuk

cenonte interesin kombëtar të popullit boshnjak.

Çfarë i parapriu vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë-Hercegovinës?

Në korrik të vitit të kaluar Asambleja Kombëtare e RS-së ka miratuar Ligjin për moszbatimin e ndryshimeve të imponuara në Kodin Penal të Bosnjë-Hercegovinës në procedurë urgjente dhe në një seancë të mbyllur. Ishte përgjigja e partive politike në RS ndaj vendimit të ish-përfaqësuesit të lartë, Valentin Inzko, me të cilin ai ka vendosur ndryshime në Kodin Penal të Bosnjë-Hercegovinës disa ditë më parë. Është thënë se institucionet e RS-së të mos bashkëpunojnë me organet kompetente të Bosnjës në lidhje me zbatimin e vendimit të

përfaqësuesit të lartë. Kjo u pasua nga një bllokadë njëmuajore e institucioneve të Bosnjës nga përfaqësues të RS-së, me një kërkesë për tërheqjen e vendimit të përfaqësuesit të lartë. Vendimi i Inzkos ka ndryshuar nenin 145 a të Kodit Penal të Bosnjë-Hercegovinës, i cili parashikon një dënim me burg nga gjashtë muaj deri në pesë vjet për këdo që publikisht miraton, mohon, pakëson rëndë ose përpiqet ta justifikojë krimin e gjenocidit, krimin kundër njerëzimit ose krim luftime i përcaktuar me aktgjykim të formës së prerë. Sipas zyrës së prokurorit të BeH, rreth 40 kallëzime janë paraqitur kundër qytetarëve dhe zyrtarëve në më pak se një vit nga fillimi i ndalimit të mohimit të gjenocidit. Deri më tani nuk është ngritur aktakuzë, ndërsa nga prokuroria kanë thënë se "po punojnë sipas

rasteve të konstatuara", dhe se kërkohen kontrollime shtesë për shkak se kallëzimet nuk janë dorëzuar nga institucionet kompetente, por nga individë dhe organizata joqeveritare. Milorad Dodik, anëtar i serb i presidencës së BeH-së, është në mesin e atyre të regjistruar për mohimin e gjenocidit. Më 11 korrik Srebrenica ka shënuar 27-vjetorin e gjenocidit të kryer nga forcat serbe në atë vend në vitin 1995, në të cilën forcat serbe vranë mbi 8 000 burra dhe djem myslimanë. Masakra është cilësuar si mizoria më e rëndë në Evropë që prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ndërsa Gjykata Ndërkombëtare e Hagës e ka njohur si gjenocid. Sipas Institutit të Personave të Zhdukur të Bosnjë-Hercegovinës, mbi 1 200 viktima të masakrës së Srebrenicës mbeten ende të zhdukura.

Bideni përkrah idenë e 'dy shteteve për dy popuj' gjatë vizitës në Bregun Perëndimor

Betlehem, 15 korrik - Gjatë vizitës së tij të premten në Bregun Perëndimor, presidenti amerikan Joe Biden ka ritheksuar mbështetjen e tij të vazhdueshme për idenë e "dy shteteve për dy popuj", por ka pranuar se ende nuk janë krijuar kushtet për rinisjen e bisedimeve që synojnë arritjen e një paqeje shumë të kërkuar ndërmjet izraelitëve dhe palestinezëve. Ai këtë deklaratë e ka dhënë në një konferencë të përbashkët për medie në Betlehem me presidentin e Autoritetit Palestinez Mahmoud Abbas, ku ka bërë me dije edhe ndarjen e 201 milionë dollarëve për një agjenci të Kombeve të Bashkuara që mbështet refugjatët palestinezë. "Populli palestinez po vuan në këto momente. Kjo, thjesht, mund të ndihet. Hidhërimin dhe zhgënjimin tuaj... Në Shtetet e Bashkuara, ne mund ta ndiejmë atë", ka thënë ai. Bideni ka theksuar se palestinezët "meritojnë një shtet të tyre që është i pavarur, sovran, i vazhdueshëm dhe i afërt. Dy shtete për dy popuj, të cilët kanë rënë të thella dhe të lashta në këtë tokë, duke jetuar

krah për krah në paqe dhe siguri". Edhe pse një qëllim i tillë "mund të duket shumë i largët", ai ka thënë se nuk do të hiqte dorë nga procesi i paqes. "Edhe nëse kushtet nuk janë të duhura në këtë moment për t'i rifilluar bisedimet, Shtetet e Bashkuara dhe administrata që unë drejtoj nuk do të heqin dorë nga afrimi i të dyja palëve", është shprehur presidenti amerikan. Ndërsa Mahmoud Abbas, në fjalën e tij, ka thënë se "çelësi i paqes" në rajon "nis me përfundimin e pushtimit izraelit të tokës sonë". Ai ka thënë se Izraeli "nuk mund të vazhdojë të veprojë si një shtet mbi ligjin" dhe ka thënë se vrasësit e gazetares palestinezo-amerikane, Shireen Abu Akleh, "duhet të dalin para drejtësisë". Gazetarja Abu Akleh është qëlluar në maj të këtij viti gjatë një aksioni ushtarak izraelit në Bregun Perëndimor dhe zyrtarët amerikanë kanë thënë se ajo ka të ngjarë të jetë vrasë pa dashje nga trupat izraelite. Megjithatë, ata nuk kanë thënë se si arritën në këtë përfundim dhe kjo deklaratë ka zëmëruar shumë palestinezë, përfshirë familjen e saj, që e akuzojnë ShBA-në se po përpiqet



ta ndihmojë Izraelin që t'i shmanget përgjegjësisë. Vizita e Bidenit në Bregun Perëndimor është pritur me skepticizëm dhe protesta nga ana e palestinezëve, të cilët besojnë se ai ka ndërmarrë shumë pak hapa drejt rinisjes së bisedimeve të paqes, veçanërisht pasi presidenti Donald Trump i ka anashkaluar ato, duke favorizuar haptazi Izraelin. Raundi i fundit i bisedimeve që synonin krijimin e një shteti të pavarur palestinez u ndal më shumë se një dekadë më parë, duke lënë miliona palestinezë të jetonin nën sundimin ushtarak izraelit, raporton REL. Qeveria në largim e Izraelit ka ndërmarrë hapa për t'i përmirësuar kushtet ekonomike në Bregun Perëndimor të pushtuar dhe në Gaza. Por, kryeministri i

përkohshëm, Yair Lapid, nuk ka mandat për të zhvilluar negociata paqeje. Zgjedhjet e 1 nëntorit mund të sjellin gjithashtu në pushtet një qeveri të krahut të djathtë që është kundër krijimit të shtetit palestinez. Ndërkohë, 86-vjeçari Abbas, Autoriteti Palestinez i të cilit administron pjesë të Bregut Perëndimor të pushtuar dhe bashkëpunon me Izraelin mbi çështjet e sigurisë, është më tepër përfaqësues i status quo sesa i aspiratave palestineze. Partia e tij, Fatah, ka humbur zgjedhjet dhe kontrollin e Gazës ndaj grupit militant islamik Hamas më shumë se 15 vjet më parë. Ai ka anuluar vitin e kaluar zgjedhjet e para kombëtare, duke fajësuar Izraelin, kur Fatah dukej se po shkonte drejt një humbjeje tjetër dërmuese. Sondazhet gjatë vitit të kaluar kanë treguar vazhdimisht se gati 80 për qind e palestinezëve duan që ai të japë dorëheqje. Bideni e ka pranuar më herët gjatë vizitës se një zgjidhje me dy shtete nuk do të ndodhë "në një afat të afërt". ShBA-ja, gjithashtu, duket se e ka pranuar dështimin për të rihapur një konsullatë të Jerusalemit që u shërben

palestinezëve, e cila është mbyllur kur Trumpi ka njohur qytetin e kontestuar si kryeqytet të Izraelit. Synimi palestinez për një shtet të pavarur në Jerusalemin lindor, në Bregun Perëndimor dhe në Gaza – territore të pushtuara nga Izraeli në luftën e Lindjes së Mesme të vitit 1967 – duket më i largët se kurrë. Izraeli po zgjeron vendbanimet në Jerusalemin lindor dhe në Bregun Perëndimor, që tani janë shtëpi e rreth 700 mijë kolonëve hebrej. Palestinezët i shohin territoret e aneksuara, si pengesën kryesore për paqen, sepse ato përfshijnë territorin në të cilin do të krijohej një shtet palestinez. Shumica e vendeve të botës i konsideron vendbanimet të paligjshme. Grupet e njohura të të drejtave të njeriut kanë arritur në përfundim se kontrolli në dukje i përhershëm i Izraelit mbi miliona palestinezë përbën aparteid. Izraeli e refuzon këtë etiketim dhe e konsideron si një sulm ndaj ekzistencës së tij, edhe pse dy ish-kryeministra izraelitë paralajmëruan vite më parë se vendi i tyre do të shihej i tillë nëse nuk arrinte një marrëveshje dy shtetesh me palestinezët.

BE-ja padit Hungarinë për ligjet LGBT, lirinë e medias dhe çmimin e gazit

Bruksel, 15 korrik - Komisioni Evropian ka thënë se është duke e referuar Hungarinë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë (ECJ) për dyshimet për diskriminim ndaj personave LGBT, kufizime në lirinë e medias dhe çmimin e naftës që diskriminon automjetet e

regjistruara si të huaja. Në njoftimin e 15 korrikut është thënë se kjo po bëhet si pjesë e paketës së tij të rregullt të vendimeve për "shkeljet" që rrezikojnë të drejtat, liritë themelore ose sundimin e ligjit midis shteteve anëtare. Kryeministri hungarez Viktor

Orban ka luftuar me Brukselin për një sërë çështjesh, që nga perceptimi i kthimit demokratik dhe të të drejtave, deri të sanksionet kundër Rusisë për pushtimin e Ukrainës, zgjerimin dhe çështjet e tjera të brendshme të BE-së. Çështja e LGBT-së ka qenë një burim i

veçantë acarimi. Qeveria e Orban ka miratuar ndryshime ligjore në qershor 2021, që ka tërhequr kritika të ashpra nga Komisioni Evropian, Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës dhe anëtarët e komunitetit LGBT, të cilët kanë thënë se stigmatizojnë pakicat seksuale

dhe mbytin diskursin mbi orientimin seksual. Orbani ka hedhur poshtë vazhdimisht akuzat për diskriminim dhe ka thënë se legjislati lejon kontrollin prindëror për atë se çfarë lloj edukimi seksual marrin fëmijët në shkollë.

Rinovohet monumenti i NATO-s në Prizren

PRIZREN, 15 KORRIK (ER) - Me kërkesë të kryetarit të komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, është rinovuar monumenti i NATO-s në Prizren.

Komuna e Prizrenit ka njoftuar se një gjë e tillë është bërë bashkë me ekipin e KFOR-it, në krye

me kolonelin Marco Javarone, komandant i KFOR – RC-W dhe gjeneralin e Brigadës OF-6 të Ushtrisë Amerikane, John “Boz” Bozicevic. “Janë zëvendësuar të gjithë flamujt dhe është bërë pastrimi i ambientit në dhe rreth këtij monumenti.

Falënderojmë KFOR-in që gjithmonë gjen mënyrë për bashkëpunim me komunën tonë, ndërsa ne do të përkujdesemi që ky monument të jetë i freskët në pamje dhe në shërbim të qytetarëve të Prizrenit”, ka njoftuar komuna e Prizrenit.



1 219 raste të reja me Covid brenda 24 orëve në Kosovë

PRISHTINË, 15 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë realizuar 3 283 testime, prej tyre të infektuar kanë dalë 1 219 persona. Ndërkaq janë shëruar edhe 257 persona.

Raste aktive me Covid janë 4 225. Bazuar në raportin 24-orësh nga klinikat Covid-19 në QKUK, por edhe nga spitalet e përgjithshme, në trajtim nga Covid-19 janë 51 pacientë, të konfirmuar me Covid-19 pozitivë.

Në klinikat e QKUK-së janë të shtrirë 26 pacientë me Covid,

kurse në spitalet e përgjithshme 25 pacientë. “Klinika Infektive dymbëdhjetë pacientë; Mjekim Intensiv Qendror një pacient; Klinika e Pediatrisë nëntë pacientë; Klinika e Gjinekologjisë tre pacientë; dhe Klinika e Neonatologjisë një foshnjë”, ka njoftuar ShSKUK-ja.

Në Spitalin e Prizrenit janë dy pacientë me Covid, në atë të Gjakovës gjashtë pacientë, në Spitalin e Pejës njëmbëdhjetë pacientë, të Gjilanit katër pacientë dhe në Spitalin e Mitrovicës dy pacientë.

Të enjten Kuvendi mban dy seanca

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 KORRIK - Të enjten, më 21 korrik, Kuvendi i Kosovës do ta mbajë seancën plenare të radhës, ka vendosur Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e së premtes të drejtuar nga kryetari Glauk Konjufca, në të cilën kanë marrë pjesë edhe kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillimisht, në orën 10:00, pritet të trajtohen pikat e mbetura nga seancat e kaluara, për të vijuar më pas me seancën e re. Pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, Kuvendi do të shqyrtojë disa projektligje, raporte vjetore, vendime dhe të zhvillojë një debat

parlamentar.

Kështu, në lexim të dytë do të shqyrtohen Projektligji për produktet biocide dhe ai për ushqimin. Nga raportet e institucioneve të pavarura për vitin 2021, do të shqyrtohet ai i Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe raporti i Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT Sh.a.

Seanca do të vijojë me shqyrtimin e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 12/84, datë 22 qershor 2022, për hartimin e Planit Hapësinor të Kosovës dhe atij për hartimin e Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri”.

Ratifikimi i anëtarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të



Akreditimit do të jetë pikë e radhës, për të vijuar me debatin parlamentar në lidhje me mosliberalizimin e vizave nga

BE-ja për Kosovën. Në këtë seancë Kuvendi do ta shqyrtojë edhe mocionin përmbajtësor të GP të Vetëvendosjes për

adresimin e rezolutës për ndërmarrjen e masave nga ana e qeverisë për ballafaqimin në rritjen e çmimeve.

Rahoveci, një nga gjashtë komunat përfituese të dy projekteve të rëndësishme



RAHOVEC, 15 KORRIK (ER) - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se komuna që drejton është një nga gjashtë komunat përfituese të dy projekteve të rëndësishme. “Jam i gëzuar që sot, me përfaqësuesit e organizatës ndërkombëtare ASB (Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland), nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit për financimin e dy projekteve

të rëndësishme për komunën tonë, ku hyjnë funksionalizimi dhe rregullimi i hapësirës së jashtme të Qendrës për Qëndrim Ditor për të Moshuarit si dhe furnizimi i OJQ-së ‘Hareja’ me pajisje të teknologjisë së informacionit”, ka shkruar Latifi në “Facebook”.

Vlera e projektit “Përkrahje Shume-Dimensionale Socio-Ekonomike për familjet në

nevojë dhe institucionet” është 10 000 euro, 70 për qind e të cilave do të mbulohen nga organizata ASB, që përkrahjet nga Qeveria e Gjermanisë, ndërkaq 30 % nga komuna e Rahovecit.

“Falënderoj përfaqësuesit e organizatës dhe Qeverinë e Gjermanisë për përkrahjen e vazhdueshme të komunës sonë!”, ka shkruar kryetari Latifi.



PDK-ja: Qeveria Kurti po thellon varfërinë, migrimin dhe falimentimin e firmave

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kërkuar nga qeveria Kurti që të reagojë urgjentisht në lidhje me krizën ekonomike në vend. Zyrtarë të kësaj partie kanë vlerësuar se rritja e çmimeve të të gjitha produkteve esenciale, inflacioni dhe mosveprimi i qeverisë me pako konkrete, është duke ndikuar që familjet të shkojnë drejt varfërimit, punëtorët drejt Perëndimit dhe firmat drejt falimentimit. Në këtë kontekst, Blerand Stavileci dhe Arben Mustafa, kanë kërkuar nga qeveria Kurti t'i lirojë nga TVSh-ja mallrat esenciale të konsumit dhe ta heqë akcizën në produktet e naftës për një periudhë të caktuar kohore

prodhojnë kriza familjare, sociale dhe psikologjike, e krizat familjare, sociale dhe psikologjike, po prodhojnë ikjen dhe po shtojnë radhët rekorde të ikjeve para ambasadave të huaja. Familjet po shkojnë drejt varfërimit, punëtorët drejt Perëndimit e firmat drejt falimentimit”, ka thënë Stavileci.

Më tej, Stavileci ka thënë se, krahas pandemisë dhe krizës energjetike, armiku numër një për të gjitha familjet, punëtorët dhe firmat, është bërë inflacioni. “Qeveritarët e Albin Kurtit nuk do të duhej të sillëshin si sehirxhi. Qeveria nuk është spektatore. Ajo duhet të jetë aktore dhe promotore e zhvillimit. E nëse këtë s'mund ta bëjë, atëherë minimalisht le të kujdeset që qytetarëve dhe familjeve t'u ndihmojë në përballje me këto kriza”, ka deklaruar Stavileci.

Ndërsa koordinatori i Departamentit për Financa në Kabinetin për Qeverisje të Mirë, Arben Mustafa, ka thënë se ritmi me të cilin po zhvillohet inflacioni në Kosovë paraqet një shqetësim shumë serioz për ekonominë e vendit, përderisa sjellja e deritanishme e qeverisë kundrejt këtyre zhvillimeve ka qenë neglizhente dhe e papërgjegjshme. “Refuzimi për t'i

përdorur instrumentet fiskale në dispozicion të qeverisë, siç janë akciza dhe Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, ka krijuar kushtet që inflacioni ta përshpejtojë ritmin e rritjes. Zhvillimet në tregjet ndërkombëtare, përfshirë edhe zhvlerësimin e valutës euro ndaj dollarit amerikan, sugjerojnë se kriza e inflacionit vetëm sa do të shkojë duke u përkeqësuar”, është shprehur Mustafa.

Më tej, ai ka shtuar se integrimi i pritjeve për inflacionin në vendimet e qytetarëve dhe firmave në Kosovë rrezikon të krijojë një valë të re inflacioni, e cila më nuk lidhet vetëm me produktet e importuara, por edhe me produktet dhe shërbimet e prodhuara brenda vendit. Ai ka theksuar se tendenca për ta adresuar problemin e inflacionit përmes kontrollit të marzhave të profitit është një politikë e gabuar dhe e pamatur për disa arsye: “Së pari, para se të mendohet për kontrollin e marzhave të profitit, qeveria duhet të ofrojë evidencë të bazuar në analiza profesionale që vërteton se rritja e çmimeve të produkteve esenciale në Kosovë po ndodh për shkak të abuzimit me marzhat e profitit e jo për shkak të zhvillimeve të tregut. Së dyti, kontrolli i marzhave të

profitit, që në një mënyrë paraqet edhe kontroll të çmimit, cenon funksionimin e ekonomisë së lirë të tregut, pengon konkurrencën dhe mund të prodhojë probleme shtesë për ekonominë e vendit. Së treti, disponimi i qeverisë aktuale për të interferuar në çmimet e sektorit privat, në vend se t'i përdorë instrumentet e politikave ekonomike në dispozicion, rrezikon lirinë ekonomike dhe krijon pasiguri për të ardhmen e ekonomisë së lirë të tregut në Kosovë. Së katërti, përvojat ndërkombëtare tregojnë se politikat e kontrollit të çmimeve në të kaluarën janë dëshmuar jo të suksesshme në luftën kundër inflacionit”, ka thënë Arben Mustafa.

Sipas tij, qeveria nuk duhet të humbë kohë edhe më tutje duke improvizuar me masa, por kërkohet që urgjentisht ta ushtrojë rolin që i takon, duke shfrytëzuar politikën fiskale për të ndikuar në frenimin e rritjes së çmimeve. “Është nevojë urgjente dhe e domosdoshme që të bëhet liri nga TVSh-ja e mallrave esenciale të konsumit për një periudhë të caktuar dhe të largohet akciza dhe të zbritet TVSh-ja në produktet e naftës për një periudhë të caktuar kohore”, ka thënë Mustafa.

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 15 KORRIK - Anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, Blerand Stavileci dhe koordinatori i Departamentit për Financa në kuadër të Kabinetit për Qeverisje të Mirë, Arben Mustafa, në një konferencë për medie i kanë bërë thirrje qeverisë të reagojë urgjentisht në lidhje me krizën ekonomike në vend.

Rritja e çmimeve të të gjitha produkteve esenciale, e inflacionit dhe mosveprimi i qeverisë me pako konkrete, po bën që familjet

të shkojnë drejt varfërimit, punëtorët drejt Perëndimit e firmat drejt falimentimit.

Blerand Stavileci, duke numëruar sfidat me të cilat po ballafaqohen sot qytetarët e Kosovës, ka thënë se e vetmja qeveri në botë që nuk po e pranon krizën dhe nuk po vepron për ta lehtësuar atë, është qeveria e Albin Kurtit. “Rëndimi i firmave kosovare me vendime të paqëndrueshme arbitrare zvogëlon të hyrat për to dhe ka efekt direkt në shkurtimin e vendeve të punës dhe rritjen e papunësisë. Papunësia krijon pasiguri. Papunësia dhe pasiguria

Ujë i pakontrolluar rrjedh në krojet e qytetarëve të Kosovës

Rreth 450 qytetarë të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit kanë kërkuar ndihmë mjekësore në dhjetë ditët e fundit pas përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, me sa duket, nga pirja e ujit të ujësjellësit. Eksperti i ujit, Skënder Bublaku, ka vlerësuar se duhet një strategji e re e furnizimit të qytetarëve me ujë të pijshëm. Ai ka thënë se në disa fshatra të Kosovës ka sisteme të veçanta të ujësjellësit të cilat nuk janë nën menaxhimin e kompanive rajonale dhe rrjedhimisht nuk u nënshtrohen analizave dhe kontrolleve



PRISHTINË, 15 KORRIK - Rreth 450 qytetarë të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit - të dyja komuna në pjesën jugore të Kosovës - kërkuar ndihmë mjekësore në dhjetë ditët e fundit pas përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, me sa duket, nga pirja e ujit të ujësjellësit. Marramendje, të vjella, kokëdhimbje, temperaturë e diarre ishin simptomat që raportuan ata. Mostrat e ujit, të marra në disa lokacione në Kaçanik dhe Han të Elezit, zbuluan se uji aty kishte nivel të lartë të baktereve.

Një banore e fshatit Rekë të Kaçanikut, e cila u trajtua nga mjekët për të vjella, temperaturë e simptoma të tjera, thotë se nuk ndihet më e sigurt ta përdorë ujin e ujësjellësit. "Këto (institucionet) po thonë se nuk ka vend për panik, por unë e kam panikun në shtëpinë time. Këto po thonë se nuk ka vend për panik, por unë e di se çfarë kam përjetuar. Nuk kam pasur mundësi të shkoj te mjeku. Kam qenë keq dhe kanë ardhur [nga ambulanca] dhe më kanë marrë", ka thënë ajo për "Radion Evropa e Lirë".

Drejtori i Qendrës së Mjekësisë

Familjare në Kaçanik, Sinan Zeneli, ka thënë se simptomat që kanë përjetuar pacientët, kanë qenë kryesisht të lehta por, sipas tij, ekziston gjithmonë rreziku që helmimet e tilla të shkaktojnë gjendje më të rëndë. "Çfarë po shohim ne, nuk është diçka që e rrezikon pacientin. Sikur të vazhdonte ai avaz dhe të mos kishte paralajmërime për këtë situatë, nuk mund të them se ajo do të kalonte pa pasoja (më të mëdha)", ka thënë Zeneli. Zyrtarët komunalë u kanë kërkuar banorëve të Kaçanikut dhe të Hanit të Elezit që të mos e përdorin ujin e ujësjellësit pa e vluar paraprakisht.

Burime të pasigurta dhe mungesë menaxhimi

Ngjarje të tilla mund të ndodhin edhe në komuna të tjera, përfshirë këtu Drenasin, Skenderajin, Deçanin dhe Suharekën. Kështu ka paralajmëruar Skënder Bublaku, ekspert i ujërave në Kosovë. Në disa fshatra të këtyre komunave, ka thënë ai, ka sisteme të veçanta të ujësjellësit, që nuk janë nën menaxhimin e kompanive rajonale dhe, rrjed-

himisht, nuk u nënshtrohen analizave dhe kontrolleve. "...pra, janë zona që kanë burime të veçanta të ujit e që, potencialisht, nëse nuk administrohen, nuk janë në rregull teknikisht, nuk u dezinfektohet uji, janë burim i ndotjes", ka thënë Bublaku për "Radion Evropa e Lirë". Për ta rritur sigurinë dhe cilësinë e ujit që pinë qytetarët, Bublaku thotë se të gjitha rrjetet e ujësjellësve duhet të futen nën menaxhimin e kompanive rajonale, të cilat janë përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ujit.

Pikërisht në fshatrat e Kaçanikut, ku edhe janë helmuar qindra banorë, ndodhet një ujësjellës vetjak, që thuhet se nuk është nën menaxhimin e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Bifurkacioni".

Kryetari i Kaçanikut, Besim Ilazi, ka thënë se përgjegjësia bie mbi këtë kompani. Ai tregon se autoritetet lokale vitin e kaluar kanë investuar 150 mijë euro në rritjen e kapaciteteve të ujit dhe shpërndarjes së tij, si dhe kanë nënshkruar një kontratë të re këtë vit, për të njëjtin qëllim, në vlerë prej 203 mijë eurosh. "Këto

janë mundësitë tona, edhe pse s'e kemi obligim ligjor, por vetëm moral, për shkak se është komplet punë e Qeverisë dhe Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal 'Bifurkacioni'", ka thënë Ilazi.

Me gjithë përpjekjet, "Radio Evropa e Lirë" nuk ka arritur të marrë ndonjë deklaratë nga "Bifurkacioni" e as nga Ministria e Ambientit e Kosovës.

Burbuqe Nushi nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka thënë se në disa prej fshatrave - ku së voni është raportuar numri më i madh i qytetarëve me probleme shëndetësore pas pirjes së ujit - ujësjellësi nuk është në menaxhim të askujt. Sipas saj, në mostrat e analizuar të ujit nuk është gjetur klor - materie që përdoret për dezinfektimin e ujit të pijshëm. "Faktikisht, furnizohen me ujë prej sistemeve individuale, prej sistemeve të vogla lokale, të cilat nuk janë absolutisht të menaxhuara nga askush. Nuk kanë dezinfektim. Klor s'ka në asnjërin prej mostrave. Resurset ujore janë të pambrojtura dhe pritet që në sezonin veror të ketë edhe

ndotje", ka thënë Nushi. Sipas saj, ndotjet bakterore dhe kimike janë më të shprehura gjatë verës sepse, siç thotë, bie niveli i ujit. Eksperti i ujit, Skënder Bublaku, ka thënë se duhet një strategji e re e furnizimit të qytetarëve me ujë të pijshëm. "Duhet të analizohet çdo fshat. Duhet të bëhet një regjistër i fshatrave që nuk mbulojnë prej kompanive rajonale të ujësjellësit. Të vizitohen dhe të bëhet një analizë e vendburimeve, sepse unë besoj se problemet, kryesisht lidhen me vendin ku merret uji", ka thënë Bublaku.

Në korrik të vitit 2021 rreth 1 600 qytetarë të Deçanit - komunë në pjesën perëndimore të Kosovës - kërkuar ndihmë mjekësore për shkak të keqësimit të shëndetit të tyre pas pirjes së ujit nga ujësjellësi. Ata kishin simptoma të ngjashme me ato të qytetarëve të Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, përfshirë: vjellje, marramendje, diarre dhe temperaturë.

Analizat e para konstatuan se uji në Deçan ishte i pijshëm, por më vonë u konfirmua se në disa lokacione kishte prani të bakterit "E.Coli".

Në shkurt të këtij viti, Prokuroria Themelore e Pejës bëri publike ngritjen e aktakuzës për drejtorin e kompanisë rajonale "Hidrodrini" dhe të kimistes së kësaj ndërmarrjeje, nën dyshimet për dy vepra penale: "shkaktim i rrezikut të përgjithshëm" dhe "mosevitim i rrezikut". "Hidrodrini" menaxhon rrjetin e ujësjellësit që furnizon me ujë të pijshëm shumicën e qytetarëve të Deçanit. Ai furnizon me ujë edhe Pejën, Istogun, Klinën dhe Junikun.

Kelmendi viziton drejtuesit e UÇK-së në Hagë: Gjykata Speciale është e njëanshme

HAGË, 15 KORRIK (ER) - Gazetari Adriatik Kelmendi ka njoftuar se i ka vizituar liderët e UÇK-së në Hagë. Kelmendi, gjatë vizitës së tij, është takuar me Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin. "Sapo përfundova vizitat te Hashim Thaçi, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi në Hagë. E takova edhe Kadri Veselin. Dy herë e kam intervistuar dhe kam dëgjuar argumentet e presidentes së Dhomave të Specializuara, gjyqtarës Ekaterina Trendafilova, me të cilën kemi dakordim edhe për një intervistë të tretë. Disa herë i kam intervistuar dhe i kam dëgjuar argumentet e avokatëve ndërkombëtarë dhe vendorë të të akuzuarve", ka shkruar Kelmendi në "Facebook".

Kelmendi ka shtuar se Gjykata

Speciale është gjykatë e njëanshme, e bërë kundër një etnie, asaj shqiptare. "Vazhdoj ta mendoj, ta shkruaj dhe ta them me zë të lartë atë që ua kumtoj edhe diplomatëve të huaj dhe kujtdo që i intereson, se kjo gjykatë është e njëanshme, se është bërë kundër një etnie, asaj shqiptare dhe, si e tillë, është e paprecedencë në analet e drejtësisë; është nisur me një supozim për krime të caktuara, 'trafikim të organeve', por ka përfunduar me aktakuzë krejt gjithëpërfshirëse; është e çuditshme se me krimet e supozuara të ndërlidhura me luftën janë marrë Gjykata e OKB-së në Hagë, gjykatat e UNMIK-ut, ato të EULEX-it, gjykatat vendore dhe gjykatat e Serbisë, por tash u desh të



krijohet edhe një kreaturë hibride që fillon me diçka e trajton krejt tjetërçka; është krejtësisht joprofesionale që procedurat gjyqësore të zgjasin

përtej çfarëdo afati ligjor dhe të bien ndesh edhe me Kushtetutën e Kosovës, me ligjet e së cilës është themeluar dhe askush të mos thirret në

përgjegjësi për këto lëshime; dhe se, mbi të gjitha, gati 25 vjet pas fillimit të luftës, në procese gjyqësore janë disa shqiptarë që luftuan për t'u çliruar nga krimet e Millosheviqit, kurse Millosheviqi nuk u dënua kurrë dhe serbë të niveleve të larta nuk ka nëpër gjykata për krimet e shumë luftërave që kanë zhvilluar", ka shkruar Kelmendi, duke shtuar se gjithmonë është angazhuar për viktimat dhe për drejtësinë. "Vazhdoj të angazhohem për viktimat dhe për drejtësinë. Por të gjithë e dimë se nganjëherë është një vijë shumë e hollë që ndan drejtësinë me padrejtësinë. Se duke mos pasur kujdes, mund të shkaktohen viktima të tjera. E pastaj në vend të drejtësisë arrijmë padrejtësinë!", ka shkruar Kelmendi.

Opozitës i thënçin opozitë, opozitarizmi krejtësisht i tredhur!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Në mungesë të minjve, macet bëhen luanë: Gjendjen në Kosovë e kemi si e kemi, pozita është dominuese në çdo fushë shkaku i numrave që i ka në Kuvend duke e shkelur, në raste e raste edhe duke e turpëruar opozitën kurse opozita po sillet sikur të ishte pjesë e sistemit politik e parlamentar të Madagaskarit. Pozita po e kalon çdo ligj apo nismë që e ka premtuar në fushatën zgjedhore pavarësisht se a do të jetë i zbatueshëm apo jo duke u mbështetur në një parim krejtësisht komunist se; prej kuantitetit del kualiteti! Nuk ka qeveri që e ka ngritur nepotizmin dhe klientelizmin në një nivel aq të lartë e që askujt nuk i jep llogari. Nuk ka qeveri që punësimet në baza nepotiste thuaja i ka bërë pjesë të sistemit duke i legalizuar ato e që, jo se nuk ndjenë përgjegjësi por krijon arsytim për secilin veprim. Nuk ka qeveri që ka qenë më jotransparente në bisedime me Serbinë e që vazhdon të jetë e tillë edhe sot duke e caktuar si kryenegociator një analfabet politik funksional si puna e Besnik Bislimit. Për të gjitha këto, ka shumë edhe për të përmendur, LV-ja e ka mbajtur Kosovën në gjendje lufte, që nga themelimi e deri te marrja e pushtetit me 51% të votave. Realisht, sot në Kosovë e kemi një demokraci krejtësisht të kontrolluar dhe të mbikëqyrur nga pushteti e që në përfundim quhet diktaturë paqësore që, lehtësisht mund të përfundojë në diktaturë të dhunshme që pashmangshëm do ta prodhojë një rezistencë të dhunshme, nëse jo nga opozita atëherë, sigurisht nga ndonjë forcë tjetër e cila do t'i përgjigjej dhunës institucionale, me dhunë fizike. Sot kemi një qeveri, unë e quaj të baustellës ku disa ministra në aspektin kombëtar nuk dallojnë nga regjimet e mëparshme antishqiptare. Së paku nëse i referohemi deklaratave të disa

ministrave siç ishte rasti i Hekuran Muratit dhe sufleres që me një kryeneqësi të paimagjinueshme po e luan rolin e ministres për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Donika Shvarc. Merreni listën me emra të ambasadorëve që janë propozuar nga Albin Kurti përmes Vjosa Osmanit e që, me kënaqësinë më të madhe e ka noterizuar zonja Shvarc dhe lehtësisht e vëreni se, ose kanë qenë bijë e bija të dhunuesve të gjithë atyre që kanë kontribuar për çështje kombëtare ose, në rastin më të lehtë në mënyrë aktive, si anëtarë të medieve apo mendermethënë shoqërisë civile kanë punuar kundër interesave kombëtare dhe politike kurse, kryeministrin aktual Albin Kurtin e patën gozhduar më keq se Jezu Krishtin. Tash, duke e lëpirë kurorën prej therrave të murrizit që i kishin vënë mbi kokë Krishtit (Albinin), po bëhen më albinë se vet Albinin, më Vetëvendosje se e gjithë Vetëvendosja dhe më patriotë se sakrifikesit më të mëdhenj. Të poshtët dhe të pafytyrë janë këta kameleonë dhe jargë njerëzore! Mirëpo, tash rolet janë ndërruar; Albin Kurti nuk është më Krishti por Pont Pilati duke i shkelur të gjitha premtimet dhe duke u arsyetuar se çdo veprim apo vendim po e merr shkaku i atyre që 20 vjet ishin në pushtet në Kosovë e të cilët nuk kanë marrë vendime të mira por, në mesin e vendimeve të këqija, këto të Albinin dhe Bislimit qenkan më pak të këqija! Çfarë hipokrizie! Merreni sot gjendjen në shëndetësi ku një ministër i baustellës, mbathur me kaubojka e trajton Kosovën si ranç kurse pacientët (banorët) i trajtojnë si banorë të rançit (lopë apo në planin më afirmativ, si kuaj). Apo kjo ministria e Tregtisë, Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, më shumë kujdeset për mirëqenien e indianëve të Utar Pradeshit se qytetarëve të Kosovës. Megjithatë, ka zbuluar diçka që nuk ka fort të bëjë me kualifikimin e pakualifikuar për punën që e bënë; se si një fëmijë mund ta shkelë një veturë e jo vetura fëmijun! Me këtë teori i ka shkelur dy shkencëtarët më të mëdhenj të fushës, Albert Ajnshtajnin dhe Jahja Kokën! Hekuran Murati, si plakat e këtyrehershme që e ruanin kapitalin në një qese në gjoks

por se kur e kërkonte nevojë e zgjidhnin qesen, ai ato para i ruan në prapanicë dhe nuk ka prapanicë ta bëjë asnjë veprim për të ndihmuar qytetarët në rrethana kur inflacioni ka kaluar 14% duke kontribuar në varfërimin galopant të qytetarëve. Pasi në ekonomi i ka zgjidhur të gjitha problemet i ka dalë koha të merret me veteranët e UÇK-së, si autoritet i dëshmuar kombëtar dhe politik sikur që është i njohur që me robë e fëmi është sakrifikuat gjatë luftës së fundit në Kosovë. Për ministrinë dhe ministrat tjerë, në shkrimet tjera! Merreni Kuvendin e Kosovës dhe analizoni shumë sipërfaqësisht paraqitjet e deputetëve të opozitës dhe të pozitës. E shihni se shumica e tyre e kanë humbur rrugën në oborr, në vend se të shkojnë e të vijojnë një kurs elementar të analfabetizimit politik dhe parlamentar, flasin e sillen sikur të ishin qendra e botës! Presidentja Vojsa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti janë kundërshtarët më të mëdhenj të Rusisë dhe Vladimir Putinit sikur edhe përkrahësit më të mëdhenj të Ukrainës dhe të Volodimir Zelinskit të cilin bota gabimisht e konsideron si president të Ukrainës. Definitivisht, edhe Kurti sikur edhe Vojsa Osmani janë shpresa e vetme e botës që të zgjidhin problemin e Ukrainës meqë angazhimin kryesor e kanë në këtë front kurse punën në Kosovë e kanë fakultative, kthehen për vizita familjare. Opozita e qortoi kryeministrin Kurti për qëndrim të gjatë në Greqi në një pushimore krejtësisht modeste, edhe për standardet e Illon Maskut apo Xhef Besosit në ndërkohë që darabuku i qeverisë deklaroi se shpenzimet për qëndrim nuk i paguan qeveria por organizatori. Në fund të fundit, çka ka kjo rëndësi se kush i paguan, vendi i punës i kryeministrit është në Kosovë e jo në Athinë! Kryeministri i Kosovës ka të drejtë që të shfrytëzojë pushimin ku të dojë dhe aq kohë sa i takon me ligjin e punës, me paratë e veta dhe për këtë askush nuk mund ta sulmojë sepse nuk kanë të drejtë!

Opozitarizmi i tredhur të cilit nuk i ndihmojnë as të gjitha viagrat e Ferit Muratit: Kurrë në Kosovë nuk ka pasur opozitë më të lodhët dhe më jovepruese se që e kemi sot. E

mbaruar fare. Thonë se nuk e duan pushtetin që edhe unë besoj por se deklarojnë se Albin Kurti po punon për ta. Mendoj se Albin Kurti po punon vetëm për veten e tij dhe se e ka pushtetin 100 për qind. Kjo opozitë, në rrethanat e 51% të votave të pozitës e ka të pamundur të bëjë opozitë parlamentare konstruktive sepse po shkelet nga një pozitë me mendësi të Xhingis Kanit. Mirëpo, kjo opozitë seriozisht duhet të mendojë e të bërit opozitë jashtëparlamentare, ose, nëse këmbëngul që fushëbeteja të jetë Kuvendi i Kosovës, atëherë duhet ta mbajë nën presion pozitën me seanca të jashtëzakonshme të cilat duhet të thërrasë çdo ditë sikur edhe duke sjellë qindra e mijëra amendamente për ligjet apo nismat e propozuara nga pozita. Më kujtohet se kur partitë shqiptare kërkonin zyrtarizimin e gjuhës shqipe në Maqedoni të Veriut, VMRO - DPMNE i pati propozuar 33,000 mijë amendamente për ligjin e propozuar duke e vonuar për më shumë se tetë (8) muaj votimin e këtij ligji. LDK-ja është si është, me Lumin e Xhikës u bë pararojë e Zyrës së Vojsa Osmanit duke pritur që përmes saj, Albin Kurti t'i thërrasë të bëhen pjesë e qeverisë pasi i duhet edhe dikush tjetër për ta nënshkruar marrëveshjen me Serbinë. PDK-ja sikur po distancohet të genit parti e dalë nga lufta e lavdishme e UÇK-së duke bërë përpjekje të transformohet e që e kanë bërë punën lesh. PDK-ja vazhdimisht duhet ta theksojë dhe të krenohet se është parti që është formuar si vazhdimësi e luftës së UÇK-së, tash me mjete politike e që e kam bindjen se nuk po e bënë këtë. Madje, kontribuuesit më të mëdhenj të PDK-së për lirinë e Kosovës, ose janë të burgosur dhe syrgjynosur në Hagë, ose janë hijezuar nga ndërkombëtarët duke bërë përpjekje që politikisht të ekzekutohen nga kolaboracionistët vendorë. Ata që e sollën lirinë e Kosovës kanë emra dhe mbiemra dhe e mbajnë lavdinë e përjetshme ndërsa përfituesit e çastit janë të çastit, pa identitet kombëtar dhe patriotik. Çdokush që është aktivizuar në politikë si pjesëtarë i UÇK-së duhet të ndjehet krenarë dhe asnjëherë nuk duhet t'i nënshtrohen një oportunitizmi politik. LV-ja nuk është e interesuar ta fusë PDK-në në pushtet për dy arsye; e para sepse nuk i beson dhe se

ia ka frikën dhe, e dyta sepse PDK-ja ka deklaruar se do ta votojë Marrëveshjen përfundimtare me Serbinë e që pikërisht i duhet LV-së. PDK-ja dhe asnjëra parti politike në Kosovë e që janë në opozitë nuk duhet ta votojnë një marrëveshje të tillë për të cilën nuk pyeten fare dhe LV-ja e ka të qartë se nën trysni të ndërkombëtarëve do të detyrohen ta votojnë çdo marrëveshje që do të arrihet!

Marrëveshja me Serbinë dhe liberalizimi i vizave: Duket qartazi se Kosovës, në një afat jo shumë të largët do t'i liberalizohen vizat. Këto viza do të liberalizohen në kohën më të keqe për Kosovën e që do të ndikojnë në zbrazje të Kosovës në përpjekje për një jetë më të mirë. Natyrisht se zbrazja edhe tani është shqetësuese, pas liberalizimit i cili do të jetë i kushtëzuar, Kosova do të përgjysmohet dhe më nuk do të vlejë koha e pensionimit apo do të importojmë fuqi punëtore nga shtetet tjera, nëse gjejmë budallenj të tillë. Ndonëse nuk thuhet publikisht, procesi i liberalizimit të vizave është i kushtëzuar me arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë prandaj, jam i sigurt se është i draftuar teksti i në marrëveshje që arritja e saj nuk do të varet nga Kosova por nga Serbia dhe Aleksandër Vuçiqi. Sikur që ishte Marrëveshja e Rambujesë. Jam i sigurt se kjo qeveri dhe kjo presidente do të nënshkruajnë çdo marrëveshje dhe se gabohet rëndë opozita kur thotë se Albin Kurti nuk është në raporte të mira me amerikanët. Amerikanët krejtësisht e përkrahin Albin Kurtin ndryshe, Albinin moti do të mbetej pa pupla (pushtet)! Amerikanët janë deklaruar për një marrëveshje përfundimtare me Serbinë që nënkupton fleksibilitet, kreativitet dhe kompromis të dhimbshëm. Këtu është topi dhe kush i pranon këto rregulla apo parime, mbetet pjesë e lojës. Ta shohim, nëse gaboj në parashikimin tim, botërisht do të kërkoj falje dhe do ta përkrahë kryeministrin Kurti, pa asnjë hezitim. Por, me keqardhje e them se e vërteta do të jetë ashtu si po e them. Për këtë arsye dhe me këtë opozitë Albin Kurti mund të mbetet në pushtet në Kosovë sa Enver Hoxha në Shqipëri dhe Josip Broz Tito në Jugosllavi.

Reagime ndaj deklaratës së deputetes së LV-së për kontrollimin e medieve

PRISHTINË, 15 KORRIK - "Thirrja e hapur e deputetes [Fitore] Pacolli për ndërhyrje të drejtpërdrejtë të Qeverisë së Kosovës për t'i kontrolluar mediet është e papranueshme, pasi po perceptohet edhe si rrezik për lirinë e fjalës dhe demokracinë", thuhet në deklaratën e Platformës Rajonale të Ballkanit Perëndimor - Safe Journalists.

Safe Journalists, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës kanë reaguar ndaj deklaratës së deputetes së Vetëvendosjes, Fitore Pacolli, e cila ka kërkuar marrjen e masave nga Kuvendi dhe Qeveria për problemet që, sipas saj, kanë mediet në Kosovë. "Edhe si Kuvend, edhe si qeveri duhet të marrim masa. Vitet e fundit janë vërejtur investime të mëdha private në medie, përmes të cilave është krijuar mundësia e ndërhyrjes dhe ndikimit në disa medime kryesore dhe online, të cilat po përdoren për qëllime biznesore dhe shantazh politik. Pra, këtu kërkojmë vëmendjen e Kuvendit dhe Qeverisë që të marrim masa dhe të kuptojmë më shumë se çfarë po ndodh me funksionimin e medias, transparencën dhe identifikimin e pronësisë së medimeve", ka deklaruar

Fitore Pacolli, deputete e Vetëvendosjes, partisë në pushtet, gjatë seancës së 14 korrikut në Kuvendin e Kosovës.

Safe Journalists thotë se dënon çdo iniciativë të qeverive që synojnë kontrollin mbi medien, pasi këto përpjekje janë të papranueshme në vendet demokratike. "Çdo kërcënim ndaj lirisë së medias është kërcënim për interesin publik, demokracinë dhe të drejtat e të gjithë qytetarëve". Rrjeti Safe Journalists përfaqëson më shumë se 8 200 profesionistë të medias në Ballkanin Perëndimor. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK) në një deklaratë të përbashkët kanë shprehur shqetësimin për fjalimin, siç thonë ata, kundër medieve në Kosovë. "Thirrja e hapur e deputetes Pacolli për ndërhyrje direkte të qeverisë për kontroll ndaj medieve është e papranueshme për AGK-në dhe KMSHK-në dhe paraqet rrezik për lirinë e medias në vend", thuhet në deklaratën e përbashkët.

AGK-ja dhe KMSHK-ja thanë se mediet, shumica e të cilave janë të regjistruara si biznese në ARBK (Agjencia për Regjistrim të Bizneseve të Kosovës), kurse një pjesë tjetër si OJQ (Organizatë Jo-



Qeveritare), rregullojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet ligjeve përkatëse në Kosovë dhe rregullore të Komisionit të Pavarur të

Medieve dhe Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës. "Çdo tentim i qeverisë për të ushtruar kontroll mbi mediet është

tentativë e papranueshme për të ndërhyrë në punën e tyre. Ky është kërcënim serioz i pushtetit aktual kundër medieve".

Osmani pret mbështetjen e Polonisë në rrugëtimin euroatlantik të Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premten në takim ministrin e Jashtëm të Polonisë, Zbigniew Rau, njëherësh kryesues aktual i OSBE-së. Në takim me ministrin Rau, presidentja Osmani diskutoi për rolin e OSBE-së për mbështetjen e institucioneve të Republikës përgjatë dy dekadave të fundit si dhe për zhvillimet e fundit të sigurisë në rajon dhe më gjerë.



Sipas Osmanit, Kosova ka shënuar përparim në fushën e sundimit të ligjit,

demokracisë dhe të drejtave të njeriut, ndërkaq sa i përket dialogut me Serbinë,

presidentja Osmani ka theksuar se Kosova vazhdimisht është palë konstruktive dhe se procesi duhet ta ketë në qendër njohjen e ndërsjellë.

Përveç kësaj, me ministrin Rau presidentja Osmani diskutoi edhe për përkushtimin e Kosovës për ta mbështetur popullin ukrainas, i cili po përballlet me luftën e paprovokuar të Rusisë, për thellimin e marrëdhënieve miqësore me Poloninë, si dhe për nevojën për ta përshpejtuar perspektivën euroatlantike të Kosovës.

Osmani tha se llogaritën në mbështetjen e Polonisë në rrugëtimin euroatlantik të Kosovës. "Kosova është e përkushtuar që të kontribuojë në mënyrë aktive për një Evropë më të bashkuar, më paqësore dhe më demokratike", ka theksuar presidentja Osmani në takim me ministrin e Jashtëm polak.

Osmani në takim me ministrin Rau ka folur edhe për rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare me të cilën përfitojnë të gjithë qytetarët pa dallim.

Dorëzohet në Kuvend peticioni me 21 mijë nënshkrime për tërheqjen e mjeteve nga Trusti

Prishtinë, 15 korrik (ER) - Organizatorët e peticionit për lejimin e tërheqjes së 30 % të mjeteve të Trustit kanë dorëzuar në Kuvendin e Kosovës 21 398 nënshkrimet e

mbledhura.

Adnan Jashari, iniciator i këtij peticioni, ka thënë se po presin që Kuvendi të votojë pro Projektligjit të Trustit. "Si iniciator i trustit me disa

vullnetarë që na kanë ndihmuar për mbledhjen e nënshkrimeve kemi dorëzuar 21 398 nënshkrime në Kuvendin e Kosovës ku presim që deputetët të votojnë pro

Projektligjit që lejon tërheqjen e 30 % të Trustit. Gjithashtu, kërkesa është që sistemi pensional të kalohet në sistem të ri pensional", ka thënë Jashari.



Cilësia e grurit në Kosovë, nën normalen

PRISHTINË, 15 KORRIK - Përveç sasisë së pamjaftueshme, gruri në Kosovë, i siguruar nga sezoni i sivjetmë i korrje-shirjeve, nuk do ta ketë as cilësinë e duhur.

Bashkim Zejnullahu, kryetar i Shoqatës së Mullisëve të Kosovës, thotë se cilësia aktuale e grurit nuk jep garanci për përpunimin e të gjitha produkteve nga mielli. "Kur themi se çka i mungon grurit, ndoshta është herët të flasim pa përfunduar fushata e korrje-shirjeve. Nuk i mungon shumë, por nuk do të jap një cilësi të mjaftueshme për t'u përpunuar. Për përpunimin e bukës ndoshta nuk do të jetë problem, sepse për bukë ne vazhdimisht importojmë grurë, si përforcues të kualitetit, por për disa industri të tjera ushqimore do të jetë problem", thotë Zejnullahu për "Radion Evropa e Lirë".

Ai përmend biskotat, pastat, petët për byrek si produkte që mund të pësojnë nga cilësia më e dobët e grurit. Të pakënaqur me cilësinë janë edhe vetë prodhuesit. "Gruri, sivjet, nuk ka 'zemër', nuk e ka atë pjesën ushqyese", thotë Pal Gjuraj nga Shoqata e Bujqve Prodhues të Grurit të Kosovës. "Buka kërkon grurin e kualitetit të lartë", shton ai. Barometër për cilësinë e grurit është pesha e hektolitrit. Sa më e lartë të jetë pesha e hektolitrit në grurë, aq më e madhe është sasia e lëndës së thatë dhe rendimenti i miellit.



Në kushte normale, kjo vlerë duhet të jetë mbi 75 në një kilogram grurë. Kjo vlerë përcaktohet me peshore të posaçme, të cilën e ka çdo fabrikë e miellit. "Pesha e hektolitrit sivjet është deri në 75, kurse vitin e kaluar ka qenë deri në 82", ka treguar për "Radion Evropa e Lirë", Musa Gashi, pronar i fabrikës së miellit "Grunori" në qytetin e Skenderajt. Sipas tij, cilësia e grurit "nuk është shqetësuese".

Imer Rusinovci, profesor në Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës, konfirmon se kultura e grurit sivjet nuk i ka parametrat standardë, por thotë se mund

të përdoret për prodhimin e miellit, respektivisht gatim të bukës. "Normalisht se nën 65 [pesha e hektolitrit] nuk dedikohet për industrinë e blojës, porse sondazhet e realizuara për grurin sivjet janë të gjitha mbi 70", thotë Rusinovci për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas përfaqësuesve të bujqve dhe mullisëve, faktorët që kanë ndikuar në cilësi më të dobët të grurit janë kushtet e pafavorshme klimatike dhe plehërimi jo i duhur, për shkak të, siç thonë, rritjes së çmimit të plehut artificial. Çmimi i këtij produkti është rritur shumëfish, në vazhden e shtrenjtimit edhe të

produkteve të tjera. Gruri duhet të plehërohet domosdo dy herë. Këtë vit 100 kilogramë pleh artificial kanë arritur rreth 100 euro krahasuar me vitin e kaluar kur kanë kushtuar 32 euro. Për një hektar tokë nevojiten deri në 300 kilogramë pleh.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë në Kosovë, përkatësisht Programit për pagesat direkte 2021, për një hektar sipërfaqe të kultivuar me grurë, fermerët e Kosovës janë subvencionuar me 75 euro. Në kuadër të Programit të pagesave direkte për vitin 2022, ministri i Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës, Faton Peci, është

zotuar se do t'i subvencionojë fermerët edhe për mbjelljet vjeshtore të kulturës së grurit. Subvencionet sivjet kapin vlerën e 474 eurove për hektar, përfshirë këtu shpenzimet për pleh dhe naftë. Por, përveç cilësisë së diskutueshme, fermerët në Kosovë kanë paralajmëruar se edhe sasia e grurit, që do të sigurohet sivjet nga korrje-shirjet, nuk do të jetë e mjaftueshme për nevojat e popullatës. Sipas tyre, nevojat do të plotësohen deri në 50 për qind.

Nga Ministria e Bujqësisë kanë thënë se presin që kërkesat e qytetarëve të plotësohen deri në 70 për qind, ndërsa për cilësinë e grurit, deri më tash, nuk kanë folur.

Nevojat e popullatës së Kosovës janë për rreth 400 mijë tonë grurë në vit.

Kosova, prej vitesh, nuk i plotëson ato dhe varet në masë të madhe nga importi. Serbia është vendi prej nga importon sasinë më të madhe të grurit dhe miellit.

Gjatë vitit 2021 Kosova ka importuar 84 mijë tonë lloje të ndryshme të grurit dhe miellit nga Serbia - nga 115 mijë tonë sa ka importuar në total nga shtete të ndryshme.

Por, sivjet, edhe çmimet e këtyre produkteve të importuara janë shtrenjtuar dukshëm, kryesisht për shkak të luftës së Rusisë në Ukrainë. Rusia dhe Ukraina janë ndër eksportueset më të mëdha të drithërave në botë dhe lufta mes tyre ka shkaktuar çrregullime në tregje.

Rafuna: Do ta avancoj bashkëpunimin e bizneseve brenda dhe jashtë Kosovës

PRISHTINË, 15 KORRIK - Oda Ekonomike e Kosovës do të jetë shtëpi e sigurt për të gjitha bizneset e vendit dhe ato jashtë Kosovës, ka thënë, në intervistën për "Radion Evropa e Lirë", kryetari i ri i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna. Ai u shpreh se Oda do t'u shërbejë interesave, kërkesave dhe ankesave të bizneseve private duke i adresuar ato tek institucionet shtetërore.

Rafuna ka premtuar edhe shtim të bashkëpunimit me institucionet e larta shtetërore. "Programi im është zhvillimi tutje i Odës Ekonomike të Kosovës. Qëllimi është që Odën Ekonomike ta shndërrojme në një shtëpi të biznesit, ku do të trajtohen ankesat, kërkesat dhe idetë e biznesit. E dyta është digjitalizimi i Odës. Jemi në vitin 2022 ku shërbimet e digjitalizimit kanë avancuar. Edhe Oda duhet të avancohet

në mënyrë që t'u shërbejë bizneseve. E treta është krijimi i një partneriteti të sinqertë dhe transparent me institucionet e Republikës së Kosovës, me Qeverinë, Presidencën dhe Kuvendin e Kosovës. Në mënyrë që të gjithë se bashku të punojmë për zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe për avancimin e bizneseve qoftë brenda apo jashtë Kosovës, që automatikisht do të reflektojnë në një pasqyrë më të mirë tek investitorët e huaj për të ardhur për të investuar në vendin tonë", ka thënë Rafuna.

Ai ka theksuar se diplomacia ekonomike tani është duke u zhvilluar me një model të ri, jo vetëm në Kosovë, por edhe në të gjitha vendet e rajonit. "Kemi rastin e fundit ku Qeveria e Kroacisë ia ka bartur Odës Ekonomike të Kroacisë që ta udhëheqë diplomacinë ekonomike. Unë e kisha një ndër pikat kyçe në programin



tim dhe ideja është që së bashku, prapë theksoj, se diplomacia ekonomike udhëhiqet edhe me

presidencën dhe me qeverinë për shkak të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Dhe, në këtë trekëndësh, të vendosim një

bashkëpunim të ngushtë, në mënyrë që të kemi një program", është shprehur Rafuna.

A janë në fakt “UFO-t” armë të reja sekrete të SHBA-së ose Rosisë?



Nga Holman W. JENKINS, Jr.

Tashmë e dimë se UFO-t nuk janë sisteme sekrete ruse, deklaruan disa blogerë dhe analistë, pasi pushtimi i dështuar i Rosisë në Ukrainë, nuk arriti të prodhojë prova të aftësive të avancuara të Moskës. Në fakt, ne nuk e dimë me siguri një gjë të tillë. Është e vërtetë, që të ashtuquajturat Fenomene Ajrore të Pajidentifikuara ose UAP, siç i quan ushtria amerikane, ka të ngjarë të mos jenë ruse. Shikimet më të besueshme të supozuara, kanë qenë ato të pilotëve ushtarakë amerikanë gjatë misioneve stërvitore në hapësirën ajrore të rezervuar për operacionet stërvitore ushtarakë amerikane. Nëse objektet janë reale dhe produkt i ndonjë qeverie, ka të ngjarë të jenë tonat. Por një teknologji e tillë do të kishte një rrezik destabilizues, dhe me gjasë nuk do të zbulohet nga asnjë fuqi që e zotëronte atë. Nëse pamjet misterioze janë ato që duken – objekte të vogla fluturuese tejet të shpejta dhe shumë të manovrueshme –

atëherë ato do ta prishnin menjëherë ekuilibrin e vendosur prej disa dekadash nga armët bërthamore. Kjo pasi sistemet e supozuara pa pilot, mund të përdoren për të shkatërruar me shpejtësi dhe tërësisht forcat bërthamore të armikut, edhe pa përdorur armë bërthamore. Në pushtimin e Ukrainës, Rusia ka flirtuar me shumë rreziqe strategjike. Dhe do të kishte shumë më tepër se sa kaq, nëse do të zbulonte aftësi ushtarake transformuese. Kina dhe India do të ishin po aq të alarmuara sa SHBA-ja dhe NATO-ja, duke i dhënë fund çdo barriere që i mban ato tani gati neutrale në luftën e Rosisë. Për ata që nuk e kanë vënë re, çështja e UFO-ve u rishfaq në skenë me një urgjencë të re pas publikimit të vitit 2017 nga Pentagoni të disa videove të regjistruar nga pilotët amerikanë të objekteve fluturuese të pashpjegueshme. Vitin e kaluar, një raport i paklasifikuar nga Drejtori i Inteligjencës Kombëtare të SHBA-së (DNI), theksoi se nuk mund ta zgjidhte dot këtë mister. Në maj të këtij viti, zëdhënësi kryesor i Pentagonit i

quajti “shumë të rëndësishme” seancat dëgjimore në Kongres në lidhje me këtë çështje. Ish-shefi i CIA-s së Obamës, Xhon Brenan, deklaroi në një intervistë për mediat, se të dhënat e deritanishme sugjerojnë një “lloj aktiviteti, për të cilin disa mund të thonë se përbën një formë të ndryshme të jetës”. Raporti i DNI përmendi 80 raste midis viteve 2004- 2021, në të cilat fenomene të pashpjegueshme ajrore, u zbuluan nga lloje të shumta sensorësh ushtarakë. Përfundimi i supozuar i komunitetit tonë të inteligjencës: “Shumica e UAP-ve të raportuara, përfaqësojnë ndoshta objekte fizike”. Në një shkrim të mëhershëm, unë kam shpjeguar arsyen pse për arsye hapësinore dhe kohore, ato nuk kanë gjasë të jenë anije kozmike aliene. Një pikëpamje alternative, mund të gjendet në një libër të ri nga ish-bankieri Mark Gober, i cili e mbështet tezën e tij tek besueshmëria e shumë njerëzve, që besojnë ose dyshojnë se kanë parë prova të takimeve me alienët. Por, kushdo që përfshihet në këtë

debat, duhet të nisë të dyshojë nga deklaratat e fundit të disidentit ruse Julia Latinina, e cila po në këtë gazetë bëri thirrje javën e kaluar për një “garë të re armatimi”, duke përfshirë “armët shumë të sakta, që mund të shkatërrojnë sistemet e lëshimit të armëve bërthamore të Rosisë, dhe t’ia bëjmë të qartë zotit Putin se ne nuk kemi frikë t’i përdorim ato”. Për SHBA-në, zbulimi i aftësive të tilla do të ishte një “As” nën mëngë, madje më shumë sesa për Kremlinin. Nëse ekzistojnë, këto armë do të duhej të testoheshin diku, me shumë mundësi në ndonjë poligon ekzistues. Ndaj do të ishte i pashmangshëm vëzhgimi i tyre nga personeli i trajnuar. Raporti i DNI, lejon në një mënyrë disi ironike që programet sekrete të qeverisë të shpjegojnë vërtet pamjet e regjistruara. Histeria masive është gjithashtu një mundësi, e nxitur nga fenomene të përditshme, shpjegimi i të cilave, nëse do të mësohet, do të ishte “i mërzitshëm”, siç thoshte dikur senatori Marko Rubio. Tek e fundit shikimet e dokumentuara të UAP nga

ushtria, janë vetëm një nëngrup i vogël pretendimesh të pashpjegueshme që vërehen në mbarë botën. Një histori kryesore ka të bëjë me dëshminë e personelit ushtarak amerikan, që pretendon se vizitorët e huaj kanë përdorur teknologjinë e botës tjetër për të çaktivizuar armët tona bërthamore. I ashtuquajtur Incidenti i Pyllit Rendëllsham, është vetëm më i famshmi nga këto episode. Agjencitë e inteligjencës së vendeve të tjera, po i kushtojnë vëmendje debatit tonë për UFO-t, edhe nëse nuk po i publikojnë “përfundimet” e tyre. Vladimir Putin, ish-agjenti gjakftohtë i KGB-së, ka arsytet e tij për të reklamuar herë pas here super-armët ruse, që nuk ekzistojnë ose që ekzistojnë vetëm si projekte në letër. Kërcënimet e tij bërthamore nuk burojnë nga hiçi. Kur të hapen arkivat, mund të zbulojmë se ai po kërkon t’i kundërvihet asaj që ka frikë se janë lojërat mendore të SHBA-së, për të nxitur dyshimet e qeverisë ruse në lidhje me ekzistencën e mundshme të super-aftësive të pazbuluara të Pentagonit. | “Wall Street Journal” – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Uka: Do t'i rikthejmë trofetë në Prishtinë

PRISHTINË, 15 KORRIK - Topshënuesi i Superligës për edicionin e kaluar në fanellën e Drenicës me 19 gola në 26 paraqitje, Kreshnik Uka, është futbollisti më i ri i FC Prishtinës. Sulmuesi i mirënjohur ishte huazuar te Drenica në janar të vitit 2021, vit në të cilin Prishtina u shpall kampione. Në atë gjysmësezonë me Drenicën, Uka shënoi gjashtë gola në 14 paraqitje. 27-vjeçari ka firmosur kontratë të re dyvjeçare me FC Prishtinën, së cilës tash e disa ditë i është bashkuar në fazën përgatitore, me ç'rast në dy ndeshjet e para miqësore i ka realizuar edhe dy gola me fanellën "bardhekaltër". Uka për faqen zyrtare të klubit është shprehur i lumtur që i është bashkuar sërish Prishtinës. "Jam i lumtur që jam rikthyer në klubin më të

madh në vend. Pres me padurim fillimin e edicionit. Gjatë bisedave që kam pasur me drejtuesit e klubit dhe trajnerin Ismet Munishi, jam bindur që të jem pjesë e klubit dhe një projekti interesant", ka thënë Uka. "Synimet e Prishtinës dihet se janë gjithmonë trofetë. Duhet të jemi të fokusuar maksimalisht nga fillimi e deri në fund të edicionit si në kampionat ashtu edhe në garat e Kupës në mënyrë që t'i arrijmë objektivat", ka shtuar ai. Futbollisti Kreshnik Uka ka premtuar se do të shënojë shumë gola me fanellën e skuadrës kryeqytetase. "Tifozëve 'Plisave' dhe të gjithë atyre që e përkrahin Prishtinën u premtoj maksimumin tim dhe gola. Jam sulmues dhe priten gola", ka deklaruar Uka.



Distria Krasniqi e fiton medaljen e argjendtë në Kroaci

PRISHTINË, 15 KORRIK - Një tjetër medalje e argjendtë është shtuar në sirtarin e xhudistes Distria Krasniqi. Garuesja jonë arriti që sot ta rrëmbej të argjendtën në Grand Prix-in e Zagrebit. Distria në finale të kategorisë deri në 52 kilogramë pësoi humbje nga japonezja, Utta Abe. Deri në finale, ajo erdhi pasi triumfoi në gjysmëfinale ndaj izraelites Gefen Primo, me waza-ari. Në çerekfinale, Krasniqi eliminoi mongolezen, Khorloodoi Bishrelt. Paraprakisht, në raundin e dytë, Distria Krasniqi mposhti me IPPON xhudisten zvicerane, Binta Ndiaye. Ndërkohë, në raundin e parë e kaloi lehtësisht xhudisten qipriote, Sofia Asvestan.



Fundjavë me spektakël në 3x3 Challenger Prishtina

PRISHTINË, 15 KORRIK - Kryeqyteti i Kosovës do të mirëpresë një ngjarje të jashtëzakonshme në 3x3. Për herë të parë do të mbahet 3x3 Challenger, që do të organizohet nga 3x3 Prishtina, me mbështetje të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), komunës së Prishtinës dhe Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK). Kjo ngjarje do të mbahet më 16-17 korrik. Ditën e shtunë do të garohet nga ora 16:00 deri në orën 24:00, kurse të dielën nga ora 18:00. Ngjarja organizohet në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë. Në këtë Challenger do të marrin pjesë 14 ekipe. Turneu pritet të jetë shumë cilësor, pasi marrin pjesë



ekipe nga Gjermania, Belgjika, Holanda, ShBA-ja, etj. Për vendasit do të garojnë Ardit Pepaj, Lejson Zeqiri, Bardh Rexha dhe Arian Qallaku. Shpërblimi për vendin e parë, të dytë dhe të tretë në total është 40 mijë euro. Po ashtu, finalistët kualifikohen për në Debreçen të Hungarisë, në Masters, në ngjarjen më të madhe që mbahet. Ndeshjet do të transmetohen drejtpërdrejt nga "Kujtesa", por edhe në "Art Motion".

Batatina, pas eliminimit: Në ndeshjen e parë fati nuk ishte me ne

PODUJEVË, 15 KORRIK - Skuadra e Llapit është eliminuar nga garat evropiane pasi ka mbetur baras të enjten në mbrëmje me Budućnostin (2-2). Llapi në ndeshjen e parë në Podgoricë ka pësuar humbje me rezultat 2-0. Trajneri Tahir Batatina i ka

falënderuar të gjitha tifozët që ishin në stadiumin "Fadil Vokrri" për ta përkrahur Llapin. "Dua të falënderoj kombin shqiptar, të gjitha tifozët që ishin prezent dhe na përkrahën. Nuk mund ta përshkruaj emocionin në 'Fadil Vokrri'. U munduam të

bëjmë maksimumin në këtë ndeshje, por goli i parë i hershëm na prishi planet tona. Nëse nuk e kishim pranuar golin e dytë, mund ta kishim rikthyer. Djemtë dhanë gjithçka nga vetja. Fati nuk ishte me ne në ndeshjen e parë", ka thënë Batatina.



Kosova U20 niset për në Bullgari

PRISHTINË, 15 KORRIK - Përfaqësuesja U20 e Kosovës në hendboll (meshkujt) ka përfunduar fazën përgatitore në Gjakovë. Faza përgatitore është vlerësuar e suksesshme, ndërsa 20-vjeçarët udhëtuan të premtën në mbrëmje për në

Bullgari, ku do të paraqiten në Kampionatin Evropian të Divizionit B. Kryetrajneri Taib Kabashi është i kënaqur me punën e bërë gjatë përgatitjeve në Gjakovë. Kabashi ka përsëritur se grupi është i fortë, ndërsa ka

premtuar maksimumin e lojtarëve. Ndeshja e parë e Kosovës U20 në Varna është të shtunën me fillim nga ora 19:00. Kosova luan me Rumaninë. Të dielën është ndeshja me Maqedoninë e Veriut, ndërsa të hënën me

Ukrainën. Të mërkurën e ardhshme Kosova luan me Zvicrën, ndërsa më pas i ka edhe ndeshjet për plasman përfundimtar. Në grupin tjetër janë Izraeli, Lituania, Greqia, Luksemburgu e Britania e Madhe.



Khaka: Jesusi dëshiron të fitojë trofe edhe me Arsenalin

Londër, 15 korrik - Gabriel Jesus mund të ketë fituar "gjihtëkça" në Manchester City, por mesfushori shqiptar Granit Xhaka ka thënë se sulmuesi brazilian mbetet i vendosur ta shtojë koleksionin e tij të trofeve pas transferimit tek Arsenali. Sulmuesi brazilian u është bashkuar "topçinjve" në një marrëveshje prej rreth 50 milionë eurosh dhe iu deshën më pak se 90 sekonda për ta regjistruar golin e tij të parë për klubin gjatë një ndeshjeje parasezonale kundër Numbergut. "Përforsimet sjellin diçka më shumë se vetëm ndeshjet dhe fitoret. Sjellin mentalitetin për të fituar diçka dhe kjo është ajo që na duhet këtu. Nuk është aq e lehtë vetëm të flasësh, por duhet ta tregosh edhe në fushë", ka thënë fillimisht Xhaka për "Sky Sports". "Ata sjellin përvojë dhe sigurisht Gabby e njih Ligën Premierë. Ai tashmë ka fituar gjithçka, por më e rëndësishmja është të sjellësh lojtarë që kanë uri. Mund të fitoni shumë trofe dhe të thoni 'mirë, mjafton', por këta djem duan të



fitojnë shumë më tepër me ne. Kjo është ajo që na bën të lumtur që i kemi ata", ka shtuar Xhaka. Arsenali ka bërë disa lëvizje në afatin e verës teksa përpiqet të rikthehet në garë për një përfundim në topkatërsh në sezonin 2022/23. Ata për pak nuk arritën këtë objektivi sezonin e kaluar, që do të thotë se janë në sezonin e gjashtë radhazi jashtë Ligës së Kampionëve. Krahas përpjekjeve vendase, topçinjtë do të kërkojnë ta ndjekin lavdinë e

Ligës së Evropës. Xhaka ka thënë se kjo do të ishte metoda e tij e pëlqyer për të siguruar një vend në Ligën e Kampionëve. "Do të pëlqejta ta fitoja Ligën e Evropës për t'u rikthyer në Ligën e Kampionëve nëse jam i sinqertë sepse është një trofe. Por, nëse arrijmë të futemi në topkatërsh në Ligën Premierë dhe ta fitojmë Ligën e Evropës, kjo do të ishte më e veçantë", ka deklaruar mesfushori shqiptar Granit Xhaka.

Ferrari i bën presion Haasit për t'ia rinovuar kontratën Mick Schumacherit

MARANELLO, 15 KORRIK - U desh pak kohë që Mick Schumacher të zhblllokohej dhe t'i korre pikët e para në Formula 1. Pasi e realizoi për herë të parë këtë gjë në Silverstone, ai arriti të përsërisë një javë më pas në Austri, madje me përmirësim të ndjeshëm. Edhe në të shkuarën (Formula 2 dhe Formula 3) historia ka treguar se Mick ka pasur nevojë të paktën për një sezon e gjysmë për t'u adaptuar me kategorinë ku garon. Dhe, më pas shpërthen. Por a do të ndodhë e njëjta gjë edhe në Formula 1? Te Ferrari besojnë se po. Drejtuesit e "kokëkuqes", që kanë në pronësi pilotin e ri gjerman, po bëjnë presion te Haasi, skuadër me të cilin garon aktualisht Mick, që t'ia rinovojnë kontratën. Ajo aktuale skadon në fund të këtij sezoni. Sipas



kontratës që kanë Haas e Ferrari, kjo e fundit e sponsorizon me motorin e saj, ndërsa makina amerikane ka për detyrim të aktivizojë në pistë një nga pilotët e akademisë së makinës italiane. Më saktësisht, Mick Schumacher. "Te Ferrari kërkojnë të nisin bisedimet për rinovimin e kontratës, ndërsa ne

po presim pushimet verore për ta bërë këtë gjë. Për momentin gjërat po funksionojnë dhe besojmë se Mick ka ende potencial. Ka një mbiemër të madh, që ka bërë historinë e sportit tonë, që mund të kthehet edhe në ngërc. Ndaj, të shohim", ka thënë Gunther Steiner, shefi i Haas.

SHKURT

Fazliji edhe zyrtarisht te St. Pauli

Skuadra gjermane FC St. Pauli ka zyrtarizuar transferimin e futbollistit të Kosovës, Betim Fazliji nga FC St. Gallen. Të dy klubet kanë rënë dakord të mos i bëjnë të ditura kushtet e transferimit. Fazliji ka luajtur në St. Gallen që nga viti 2014, ku ka kaluar nëpër të gjitha ekipet e të rinjve, derisa ka luajtur 14 ndeshje për Përfaqësuesen e Kosovës.

Strakosha edhe zyrtarisht lojtar i Brentfordit

Thomas Strakosha është zyrtarisht lojtari më i ri i Brentfordit. Portieri i kombëtares së Shqipërisë ka arritur edhe në mënyrë zyrtare akordin me klubin e ri dhe për herë të parë në karrierë do të nisë një aventurë në elitën e futbollit anglez, Premierë Ligë. Sezonet e fundit nuk kanë qenë më pozitivët për Strakoshën te Lazio, por tashmë gardiani pretendon ta rigjejë formën më të mirë. Thomas Strakosha do ta ketë konkurrencën e portierit spanjoll David Raya, i cili në sezonin e fundit ka qenë titullar i padiskutueshëm. Gjithsesi kjo nuk e tremb portierin shqiptar, i cili është gati t'i luajë shanset e tij.

Erikseni paraqitet tek Unitedi

Skuadra e Manchester Unitedit e ka zyrtarizuar transferimin e mesfushorit danez Christian Eriksen. Ish-anëtari i Interit ka kaluar tek Unitedi si transferim i lirë pasi u largua nga Brentfordi, ndërsa ka nënshkruar kontratë me "Djajtë e kuq" deri në qershorin e vitit 2025. "Manchester Unitedi është një klub i veçantë dhe mezi pres të filloj. Ten Hag është një trajner fantastik. Duke folur me të, jam edhe më i emocionuar për të ardhmen", është shprehur Erikseni.

Atletico planifikon rikthimin e Ronaldos në Madrid

Cristiano Ronaldo është emri kryesor i kësaj merkatoje, me portugezin që kërkon të largohet me çdo kusht nga Manchester Unitedi në mënyrë që të luajë në Ligën e Kampionëve sërish. Me tërheqjen e Çelsit nga gara, duket se nuk kanë ngelur shumë opsione për portugezin që të zgjedhë. Një lajm i bujshëm ka ardhur nga Spanja, ku "ESPN" raporton se për 37-vjeçarin së fundmi është interesuar dhe Atletico e Madridit. Gjithsesi në terma financiarë kjo duket pak e pamundur për "Colçoneros", pasi ka edhe probleme për të arritur te zyrtarizimi i Alex Witselit. Siç thekson medie spanjolle, nëse Atletico kërkon ta kthejë Ronaldon në Madrid, atëherë duhet t'i heqë të paktën dy sulmues nga skuadra.

Anelotti: Nuk do të ketë transferime të tjera

Real Madridi e transferoi Aurelien Tchouameni nga Monaco për më shumë se 80 milionë euro, ndërsa

Antonio Rudiger erdhi nga Chelsea si lojtar i lirë. Këta dy lojtarë pritet të jenë të vetmit që Reali i ka

transferuar këtë verë. Këtë lajm e ka konfirmuar trajneri Carlo Ancelotti. "Ne nuk do të përfundojmë asnjë

nënshkrim tjetër. Jemi të kënaqur me ekipin aktual, jemi të fortë. Jam i lumtur me Rudigerin,

Tchouameni dhe jam i sigurt se Hazardi do të na ndihmojë shumë", ka thënë Ancelotti.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 9.2 dhe 15 të Ligjit 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenet 5, 6, 7 dhe 13 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021), nenit 6 të Rregullores (ZKA) Nr. 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në ZKA; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit Nr. 1289 të datës 15.07.2022, Zyra Kombëtare e Auditimit, shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të punës

Pozita: Ndhmës Auditor i Përgjithshëm
Numri i referencës: NAP/ZKA/13-07/22
Grada: ZKA-A2
Numri i pozitave: Katër (4)
Kohëzgjatja e emërimit: Me mandat Pesë (5) vjet

Qëllimi i Pozitës:

Ndhmës Auditori i Përgjithshëm është përgjegjës për funksionimin dhe koordinimin e aktiviteteve në fushën auditues, në përputhje me Planin e vjetor të auditimit (PVA) të miratuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Ndhmës Auditori i Përgjithshëm, është përgjegjës për dizajnimin dhe zhvillimin e objektivave të auditimit, si dhe bën përgatitjen e planeve të punës sipas PVA-së;
- Menaxhon dhe administron punën e përgjithshme të fushës së përcaktuar të auditimit dhe siguron zbatimin e funksioneve të tij;
- Siguron zbatimin e funksioneve të PVA-së me qëllim të përmirësimit të mandatit dhe funksionit të ZKA-së;
- Menaxhon me personelin nën vartësi të tij, si dhe në bashkëpunim me drejtorët e departamenteve të auditimit, analizojnë dhe vlerësojnë proceset e ZKA-së, si dhe në pajtim me Auditorin e përgjithshëm, vendos për ndryshimet/përmirësimet me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë;
- Me autorizim të Auditorit të Përgjithshëm, përfaqëson ZKA-në, në fushat dhe çështjet që ndërlidhen me mandatin dhe funksionin e tij;
- Ofron udhëzime dhe këshilla të sakta dhe të paanshme profesionale për Auditorin e Përgjithshëm, në fushën përkatëse;
- Bën vlerësimin e rregullt e nëpunësve nën mbikëqyrjen e tij, si dhe mbështet zhvillimin profesional të tyre përmes kryerjes së skemave profesionale të auditimit, me qëllim të kryerjes së detyrave të tyre në përputhje me standardet profesionale të punës;
- Me kërkesë të Auditorit të përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlidhen me objektivat e ZKA-së.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplome fakulteti, në ekonomi, drejtësi apo administratë publike;
- Shtatë (7) vite përvojë pune në fushën e kontabilitetit, auditimit, financave publike ose administratës publike;
- Katër (4) vite përvojë menaxheriale;
- Të jetë i certifikuar për auditim të jashtëm (auditor i certifikuar ose auditor i certifikuar i sektorit publik).

Shkathtësitë e kërkuara:

- Shkathtësi të nivelit të lartë në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të shkëlqyeshme për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negociim;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese, dhe komunikuese në menaxhim të performancës;

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Kompensimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- Formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- Dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- Dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë.

Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të plotësojnë do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, duke filluar nga data 16.07.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 31.07.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen/shkarkohen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00. Formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 9.2 i 15 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, i članova 5, 6, 7 i 13 Pravilnika (NKR) 03/2021 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (objavljeno u Službenom listu 16.09.2021), član 5 Uredbe (NKR) Br. 02/2021 o Klasifikaciji radnih Mesta u NKR; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2022. godinu (izmenjen/dopunjen), i Odluke Br. 1289 datuma 15.07.2022.godine, Nacionalna Kancelarija Revizije, objavljuje:

KONKURS za dopunu radnog mesta

Pozicija: Pomoćnik Generalnog Revizora
Broj reference: NAP/ZKA/13-07/22
Rang: ZKA-A2
Broj pozicija: Četiri (4)
Trajanje imenovanja: Sa mandatom Pet (5) godina

Svrha pozicije:

Pomoćnik Generalnog Revizora je odgovoran za rad i koordinaciju aktivnosti u oblasti revizije, u skladu sa Godišnjim planom revizije (GPR) odobren od strane Generalnog revizora.

Dužnosti i Odgovornosti:

- Pomoćnik Generalnog Revizora, odgovoran je za dizajniranje i razvoj ciljeva revizije, kao i za pripremu planova rada prema GPR-u;
- Upravlja i administrira ukupnim radom određene oblasti revizije i obezbeđuje sprovođenje njenih funkcija;
- Osigurava efikasno sprovođenje GPR-a u cilju ispunjavanja mandata i funkcije NKR-a;
- Upravlja svojim podređenim osobljem, i u saradnji sa direktorima departmana revizije, analizira i procenjuje procese NKR-a, i u skladu sa Generalnim revizorom odlučuje o izmenama/poboljšanjima u cilju povećanja efikasnosti u radu;
- Po ovlašćenju glavnog revizora, predstavlja NKR, u oblastima i pitanjima koja se odnose na njen mandat i funkciju;
- Pružta tačne i nepristrasne profesionalne smernice i savete generalnom revizoru, u relevantnoj oblasti;
- Vrši redovnu procenu zaposlenih pod njegovim nadzorom, kao i podržava njihov profesionalni razvoj kroz izvođenje šema profesionalne revizije, kako bi obavljali njihov zadatak u skladu sa standardima profesionalnog rada;
- Na zahtev Generalnog revizora, obavlja i druge poslove u vezi sa objektivima NKR-a.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma, u ekonomiji, pravosuđu ili javnoj upravi;
- Sedam (7) godina iskustva u oblasti računovodstva, revizije, javnih finansija, ili javne uprave;
- Četiri (4) godine rukovodećeg iskustva;
- Da bude sertifikovan za eksternu reviziju (sertifikovani revizor ili sertifikovani revizor javnog sektora).

Potrebne veštine:

- Visok nivo veština u upravljanju, organiziranju i postavljanju objektivata;
- Odlučno znanje za efektivan nadzor nad profesionalnim radom;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Veštine rukovođenja, motivacije i komunikacije u upravljanju učinkom;

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate za objavljenu poziciju se vrši u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura Prijave:

Procedura prijave je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa..

Kandidati treba da dostave sledeće potrebne dokumentacije:

- Službeni Formular NKR-a za prijavu;
- Kopiju lične karte Republike Kosova;
- Dokazi o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- Dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđen.

Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu. Samo službeni formular za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (online) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, počev od 16.07.2022.godine, dok je rok za podnošenje dokumentacije je 31.07.2022.godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Diviziji za administriranje dokumenatima Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručnju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete u razmatranju.



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L